



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 maj 2013
Nr. Ref.:RK414/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rastin Nr. KI 127/12

Parashtruese e kërkesës
Zade Zeqiroviq

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Kolegjit për Ankesa të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me
Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084 të 12 shtatorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesën e ka parashtruar Zade Zeqiroviq (në tekstin e mëtejme: Parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Shemsi Uka.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston aktgjykimin e Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC -09-0084 të 12 shtatorit 2012, që i është dorëzuar Parashtrueses së kërkesës më 22 shtator 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084 të 12 shtatorit 2012 i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) me rastin e, siç pretendohet nga Parashtruesja e kërkesës, mosnjohjes së të drejtës për kamatën vjetore në shumën e kompensimit të dëmit të shkaktuar nga zjarri.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese Nr. 03/L-121 të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullin 56.2 të Rregullores së Punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 dhjetor 2012, Parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 janar 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).
7. Më 5 shkurt 2013, Gjykata e njoftoi Parashtruesen dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit lidhur me regjistrimin e Kërkesës.
8. Më 29 prill 2013, me vendim të Kryetarit për zëvendësimin e Gjyqtarit raportues Nr. GJR. KI 127/12, Gjyqtarja Snezhana Botusharova u caktua Gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, me vendim të Kryetarit Nr. KSH. 127/12, u caktua Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Enver Hasani (anëtar).

9. Më 14 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

10. Sipas dokumenteve të bashkëngjitura në Kërkesë, Parashtruesja është pronare e kompanisë "Muki Trade", e cila prej 26 tetorit 1999 deri më 25 shkurt 2000 ka pasur një kontratë qiramarrjeje për shfrytëzimin e një depoje me Ndërmarrjen Shoqërore «Qendra Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike» në Prishtinë. Më 25 shkurt 2000, u paraqit një zjarr në «Qendrën Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike» në Prishtinë, i cili u përhap në depot tjera të marra me qira, duke përfshirë depon me qira të Parashtrueses së kërkesës.
11. Më 9 mars 2005, Parashtruesja e kërkesës parashtrroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, duke kërkuar kompensimin e dëmeve nga «Qendra Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike» në Prishtinë. Kopja e padisë së 9 marsit 2005 nuk i është bashkëngjitur Kërkesës nga Parashtruesja. Është aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, i datës 18 gusht 2006, që i referohet padisë së parashtruar nga Parashtruesja e kërkesës.
12. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në aktgjykimin e saj të 18 gushtit 2006, nr. SCC-05-80 vendosi që *"nuk ka kompensim që mund të jepet në lidhje me këtë padi në bazë të ligjit"*, duke shpjeguar më tutje që padia nuk është parashtruar brenda afatit pesë (5) vjeçar siç përcaktohet me nenin 376, paragrafi 2, të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore. Në të njëjtën datë, Dhoma e Posaçme nxori aktgjykimë për 12 (dymbëdhjetë) raste të ndërlidhura, duke e shpallur «Qendrën Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike» në Prishtinë përgjegjëse për dëmet e shkaktuara ndaj paditësve, si dhe duke vendosur kompensimin e dëmeve në favorin e tyre.
13. Më 25 mars 2008, Parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesë për rigjykim të rastit. Përfaqësuesi i Parashtrueses së kërkesës Dhomës së Posaçme i dorëzoi provat që më 16 mars 2004, ishte dorëzuar padia për të njëjtin kompensim dëmsh në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Faktet e dorëzuara në Dhomën e Posaçme ishin në formën e një vendimi të Gjykatës Komunale të Prishtinës, të datës 6 shkurt 2008.
14. Në bazë të provave të dorëzuara nga Parashtruesja e kërkesës, që konfirmojnë që padia ishte parashtruar për të njëjtin kompensim në Gjykatën Komunale, më 20 qershor 2008, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme vendosi të rigjykojë rastin.
15. Më 10 shtator 2008, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, duke iu referuar juridiksionit të saj në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 gjithashtu nxori një aktvendim për të tërhequr nga Gjykata Komunale në Prishtinë rastin C. Nr. 254/08 të parashtruar nga Parashtruesja e kërkesës.

16. Dhoma e Posaçme angazhoi një ekspertizë të përgjithshme për vlerësimin e shumës së dëmeve që ishin shkaktuar nga zjarri.
17. Më 15 tetor 2009, Paneli Gjyqësor i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në aktgjykimin e tij SCC-05-0080 shpalli «Qendrën Sociale, Sporteve, Kulturës dhe Ekonomisë» në Prishtinë përgjegjëse për dëmet, si dhe kështu obligoi «Qendrën Sociale, Sporteve, Kulturës dhe Ekonomisë» në Prishtinë t'i paguajë paditësve kompensimin e dëmeve. Në rastin e Parashtrueses së kërkesës, Paneli gjyqësor urdhëroi që të paguhen 106,650 EUR në emër të dëmeve, në vend të shumës së pretenduar prej 195,000 EUR.
18. Më 12 nëntor 2009, Parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme duke kërkuar që të korrigjonte aktgjykimin e 15 tetorit 2009, si dhe të përfshinte kamatën prej 3.5 % për Parashtruesen e kërkesës në dispozitivin e Aktgjykimit.
19. Më 21 maj 2010, Paneli Gjyqësor i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme hodhi poshtë kërkesën si të papranueshme, duke argumentuar që Aktgjykimi i 15 tetorit 2009 ishte dorëzuar tek Parashtruesja e kërkesës më 18 tetor 2009, dhe që Parashtruesja e kërkesës kishte dorëzuar kërkesën më 12 nëntor 2009, duke e konsideruar kështu kërkesën të pasafatshme, sipas nenit 49.1 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2008/6. Në fakt, Trupi Gjykues nuk mori parasysh që vonesa e pretenduar ishte e përfshirë në termin "*Gabime teknike*". Paneli Gjyqësor më tutje argumentoi që Parashtruesja e kërkesës ka kërkuar «aktgjykim plotësues, e jo të korrigjuar», si dhe e shpalli kërkesën për ndryshim të aktgjykimit si të afatshme, por të pabazuar, duke konsideruar që aktgjykimi fillestar kishte nënkuptuar që Parashtruesja e kërkesës nuk kishte kërkuar kamatat ligjore. Paneli Gjyqësor theksoi që "*çdo kundërshtim në lidhje me këtë duhet korrigjuar, nëse shpallet i bazuar, vetëm me vendimin e shkallës së dytë.*" Në këtë rast, Trupi Gjykues vendosi që kërkesa e Parashtrueses nuk mund të konsiderohet si padi e re, pasi që procedura e regjistrimit është specifike, dhe as nuk mund të konsiderohet si ankesë, pasi që nuk përmbush kriteret e përcaktuara me nenin 60.1 të Urdhërësës Administrative (AD) 2008/6.
20. Më 7 korrik 2010, Parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin për ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke kërkuar kompensimin e vonesës së pagesës së kamatës me të njëjtën shumë si në rastet tjera, duke filluar nga 25 shkurti 2000 deri në pagesën përfundimtare. Parashtruesja e kërkesës pretendonte që disa raste ishin shqyrtuar në mënyrë kolektive, duke obliguar "Qendrën Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike" në Prishtinë që të paguajë kamatë vonesën, si dhe gjithashtu pretendonte që në dokumentet e mëhershme ka kërkuar kompensimin për gjitha shpenzimet procedurale. Parashtruesja në ankesë gjithashtu i referohet Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të datës 18 gusht 2006, në të cilin Dhoma e Posaçme thekson që padia ka të bëjë me kërkesën për të obliguar "Qendrën Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike" në Prishtinë që "*të paguajë*

kamatën për shkak të vonesës në shumën prej 5 % në vit, duke filluar nga dita e zjarrit e deri në pagesën përfundimtare.”

21. Kolegji për ankesa i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me aktvendimin e tij ASC-10-0045, të datës 13 shtator 2012, hodhi poshtë ankesën e parashtruar nga Parashtruesja e kërkesës si të pabazuar, si dhe konfirmoi vendimin e Trupit Gjykues SCC -05-0080, të datës 21 maj 2010.
22. Kolegji për ankesa në vendimin e lartpërmendur, thekson që:
[...]
“Është e saktë që DHPGJS-ja më 18 gusht 2006, në Aktgjykimin e saj thekson që padia e Ankuesit e 9 marsit 2005 përbëhet nga kërkesa për të obliguar të Paditurin e parë që të paguajë kamatë, për shkak të vonesës, në shumën prej 5 për qind në vit, duke filluar nga dita e zjarrit deri në pagesën përfundimtare. Megjithatë, kjo kërkesë nuk mund të gjendet në shkresat e rastit SCC-05-0080, e as në dokumentet e ankesës në Kolegjin për Ankesa. Thëniet e DHPGJS-së më 18 gusht 2006 kështu nuk mund të konsiderohen si provë që ka pasur kërkesë për kamatë para 18 gushtit 2006.”

Kolegji për ankesa më tutje i referohet padisë së Parashtrueses së kërkesës në shkresat e rastit të Trupit Gjykues SCC-05-0080, dorëzuar më 15 dhjetor 2008, në të cilin Parashtruesi kërkon pagesën e kamatëvonesës , por argumenton që [...] *“në bazë të nenit 376.2 të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore, e drejta e parashtrimi të padisë skadon pesë vjet pas shkaktimit të dëmtimit apo humbjes, kështu që kërkesa e paditësit e datës 15 dhjetor 2008 nuk është e afatshme.”*

23. “Qendra Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike” në Prishtinë, Agjencia e Kosovare e Privatizimit, si dhe World Company, parashtruan ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, respektivisht më 23 nëntor 2009, 20 nëntor 2009 dhe 16 nëntor 2009, kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të datës 15 tetor 2009, për rastet e bashkuara SCC-05-80, SCC-06-0029, SCC-06-0470, SCC-06-0482 dhe SCC- 06-0524.
24. Kolegji për ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në aktgjykimin e tij të datës 12 shtator 2012 vendosi të shpallë ankesën e “Qendrës Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike” në Prishtinë pjesërisht të bazuar, si dhe të ndryshojë Aktgjykimin e Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 15 tetor 2009, duke obliguar “Qendrën Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike” në Prishtinë t’i paguajë Parashtrueses dhe paditësve tjerë si në vijim: *“75,000 EUR Parashtrueses së kërkesës ; 75,000 EUR dhe 3.5% kamatë vjetore për dëmet nga 26 shkurti 2000 deri në ditën e pagesës për paditësin e dytë; 80,000 EUR dhe 3.5% kamatë vjetore për dëmet nga 26 shkurti 2000 deri në ditën e pagesës përfundimtare për paditësin e tretë; 65,000 EUR dhe 3.5% kamatë vjetore për dëmet nga 26 shkurti 2000 deri në datën e pagesës përfundimtare për paditësin e katërt; 180,000 EUR dhe 3.5% kamatë vjetore për dëmet nga 26 shkurti 2000 deri në datën e pagesës për paditësin e pestë.”*

Pretendimet e Parashtrueses së kërkesës

25. Siç theksohet më lart, Parashtruesja e kërkesës pohon që Aktgjykimi i Kolegjit për ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084, të datës 12 shtator 2012, ka cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 24 [Barazia para ligjit] si dhe nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm].
26. Parashtruesja e kërkesës më tutje pohon që *“Sipas Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 6/2008 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 13/2002, nenit 70 i Urdhërësës në dispozitat e saj përfundimtare përcakton që në interpretimin e asaj Urdhërese Administrative, ose në shqyrtimin e çështjeve që nuk marrin përgjigje të duhur, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat në fuqi të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas nenit 190 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si ligj në fuqi në kohën e marrjes së vendimeve nga Dhoma ka qene e paraparë që paditësi deri në momentin e mbylljes së shqyrtimit kryesor ka mundur ta ndryshojë padinë. Edhe po të mos e kishte kërkuar paditësja me padi kamatëvonesën kur e ka kërkuar me parashtrësja dhe thanje në shqyrtime para mbylljes së shqyrtimit kryesor atëherë ky pretendim nga Dhoma është dashtë të merret si i afatshëm.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

27. Para së gjithash, për të shqyrtuar kërkesën e Parashtrueses, Gjykata duhet të vlerësojë nëse Parashtruesja e kërkesës ka përmbushur të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe saktësohen më tej me Ligj dhe Rregullore të Punës.
28. Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse Parashtruesja është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, përcakton që:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Në lidhje me këtë Kërkesë, Gjykata thekson që Parashtruesja e kërkesës është person fizik, si dhe është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe palët e autorizuar] të Kushtetutës.

29. Gjykata gjithashtu duhet të vlerësojë nëse Parashtruesja e kërkesës, në pajtim me kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës, si dhe neni 47 (2) i Ligjit, ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Në rastin aktual, vendimi i fundit në rastin e Parashtruesit është Aktgjykimi i Kolegjit për ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të

Privatizimit ASC-09-0084, të datës 12 shtator 2012. Si rrjedhojë, Parashtruesja e kërkesës ka dëshmuar që ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligjet në fuqi.

30. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu duhet të dëshmojë që ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me dorëzimin e Kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e rastit mund të shihet që Aktgjykimi Kolegjit për ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084, të datës 12 shtator 2012 është dorëzuar më 22 shtator 2012, derisa Parashtruesja e kërkesës ka dorëzuar Kërkesën në Gjykatë më 7 dhjetor 2012, që do të thotë se Kërkesa është dorëzuar brenda afatit katërmujor, siç përcaktohet me Ligj dhe Rregullore të Punës.

31. Në lidhje me Kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh Rregullin 36 të Rregullores së Punës, i cili përcakton që:

“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.”

32. Sipas shkresave të rastit, Gjykata thekson që arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Kolegjit për ankesa të Gjykatës Supreme është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata gjithashtu ka gjetur që procedurat e gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, 30 qershor 2009).

33. Gjykata po ashtu rithekson që sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është mandati i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës [DHM]*, nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GjEDNJ] 1999-I, shih edhe, *Vendimi për papranueshmëri në rastin nr. 70/11, Parashtruesit Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011*).

34. Fakti që Parashtruesja e kërkesës nuk është e kënaqur me rezultatin e aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nuk mund t'i shërbejë asaj si e drejtë që të ngrisë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 24 [Barazia para ligjit] dhe nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës. (shih, *mutatis mutandis Aktgjykimin e GjEDNJ-së Apl. Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i datës 26 korrik 2005).

35. Për gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata është e bindur që faktet e paraqitura nga Parashtruesja e kërkesës nuk arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese, si dhe që Parashtruesja e kërkesës nuk ka ofruar dëshmi që të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullat 36.2 dhe 56.2 të Rregullores së Punës, më 27 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani